



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më _____._____.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje bazë materiale të ndryshme për infrastrukturën vaditëse”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

43320000-2 - Pajisje ndërtimi; **44110000-4** - Materiale ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 246 315 (një milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**, nga granditë e bashkisë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/ enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 dhe Listën e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalohet 40% të vlerës së përlloritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Ndërsa në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, dhe 2023 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra

Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Në nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “kërkon” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kritere për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 3 (tre) punonjësish të punësuar, ndër të cilët 1 (një) shofer dhe 2 (dy) punonjës për transportin e mallit, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit, në rastin kur automjeti i deklaruar është në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur automjeti disponohet me qera, punonjësi shofer i kërkuar duhet të jetë i kontraktuar.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme, si dhe
- Ndërsa për punonjësën me detyrë “shofer” të paraqitet: Leje drejtimi e kategorisë C, dhe Çertifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, **Kamion me vinq (me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton)** me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë Noteriale Huapërdorje (me kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës)

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë Noteriale Qiraje (me kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës)

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Çertifikate për transport mallrash,

f) Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat (të paktën 2).

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit**, të të gjithë artikujve/ materialeve në adresën e autoritetit kontraktor, të përfshira në këtë procedurë prokurimi.
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë garancie, që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së pajisjeve elektrike dhe elektromekanike, si: **Matrapik me bateri, Gurë fresibël me bateri, dhe Bateri gjeneratori**, për një periudhë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të secilit mall pranë autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare **dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet**. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, **kapacitetet teknike dhe profesionale**, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej 3 (tre) punonjësish, ku njëri të jetë shofer, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 40 pika 5/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e personelit që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” dhe afatit të ekzekutimit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat vërtetojnë **aftësinë e stafit që do të angazhohet për kryerjen e shërbimit (Leje drejtimi dhe Çertifikatën e aftësimin profesional)** dhe **disponimin/punësimin e tyre (listëpagesa)**, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në personelin që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2. Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë një **Kamion me vinç (me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton)** në pronësi, huapërdorje ose me qera, **i cili do të shërbejë për transportin e mallrave objekt prokurimi**, ku kapaciteti mbajtës i tij është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmasat e kontratës objekt prokurimi dhe se për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, dhe të marrjes me huapërdorje ose me qira të mjetit, si dhe dokumentacionin sipas legjislacionin në fuqi për lejimin e qarkullimit të mjeteve. Njësia vendosi të kërkoj kushtin e mësipërm sepse ai ka lidhje të ngushtë me objektin e kontratës dhe është në përpjesëtim me objektin e kontratës. **Njësia**

vlerëson se pa këtë mjet transporti një operator ekonomik nuk mund të realizoj furnizimin e mallrave të parashikuar në këtë prokurim.

3. Po ashtu, me qëllim garantimin e furnizimeve të materialeve objekt kontrate, njësia e prokurimit e vlerëson të domosdoeshëm faktin që, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet detyrimisht të **deklarojnë se marrin përsipër kryerjen e shërbimit të transportit të materialeve deri në magazinën e autoritetit kontraktor**, për të përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit për këtë prokurim, ku A.K. do t'i duhet që të paguajë kosto shtesë për transportin e materialeve.
4. Gjithashtu, Njësia e prokurimit referuar specifikës që kanë disa prej mallrave/ pajisjeve elektrike/ elektromekanike objekt prokurimi, vendosi që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **një deklaratë garancie që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së këtyre pajisjeve për një periudhë jo më pak se 12 muaj nga data e dorëzimit të mallit pranë autoritetit kontraktor**, pasi mund të gjendemi përpara rastit ku këto pajisje mund të jenë të një cilësie të dobët, të kenë defekte fabrikimi etj., ku O.E. duhet të jetë i gatshëm për zëvendësimin e tyre, gjë që i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e reputacionit dhe besueshmërisë të operatorëve ekonomikë se marrin përsipër të kryejnë furnizime të pajisjeve cilësore të kërkuar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë teknike, profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë, si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.1340/1, datë 04.04.2024** “*Relacion për përcaktimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike...*” dërguar nga Komisioni për Përcaktimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik¹*” (i ndryshuar), dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallrat objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 29.04.2024, ora 10.00**, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT